



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:156438

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05473929

**NË EMËR TË POPULLIT**

**P.nr../..**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Mus Povataj, me pjesëmarrjen të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit J..I. për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 349 par 3 lidhur me par 2 dhe par 1 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme sipas aktakuzës PP/II nr.1212/23 të datës 08.09.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 13.02.2024 në prezencë të Prokurores se Shtetit Ardiana Veseli të pandehurit J..I. dhe mbrojtësi i tije av. Menduh Mulhaxha me datë 13.02.2024 bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë 01.03.2023 përpilon këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri,

**J..L...**, i lindur me ..... në fshatin M.. K.. P.., nga i ati S.., dhe e ema H.., e vajzërisë K..., me vendbanim në rr: I.. B.. K.. P.., i pa punë, i identifikuar me numër personal të letërnjoftimit ....., posedon numër të telefonit ....., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar me parë, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

Për shkak se:

Me dt. 21.06.2023 rreth orës 14:37, në fsh. M.., pikërisht në vendin e quajtur S.., pjesë e Parkut Kombëtar “B.. e N..”, në paralelen 73-74, me qëllim të përvetësimit pasuror të kundërligjshëm, pret 7 trungje të llojit “Breu”, me gjatësi 17-20m, më vëllim të përgjithshëm prej 5.38m<sup>3</sup>, në atë mënyrë që, i pandehuri pasi fillimisht i pret drunjtë të përshkruara si me lart, të njëjtat i ngarkon në kamionin e markës “M..” me tabela të regjistrimit ..... ngjyrë portokalli, për ti transportuar për në shtëpi, gjatë bartjes së tyre tek vendi i quajtur “D..” haset nga patrulla e Policisë të Stacionit Kufitar, të cilët i sekuestrojnë kamionin dhe masën drusore, me të cilin veprim, D.. për Ad... e P.. K.. “B.. e N..”, i shkakton dëm material në shumë prej 2.387.35 €.

- me çka ka kryer, veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 349 par 3 lidhur me par 2 dhe par 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 7, 17, 21, 38, 43,47, 49, 69,70 dhe 349 par.3 lidhur me par 2 dhe par 1 të KPRK-së, si dhe nenit 242 dhe 364, të KPPRK-së, të pandehurit J..I. i shqipton:

### **GJYKON**

**DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit komfor nenit 44 të KPRK-së, i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej 500,00 (pesëqind) euro dhe **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 100,00 € (njëqind euro).

Konform nenit 76 të KPRK-së të pandehurit i shqiptohet **DËNIM UNIK ME GJOBË** në shumë prej **600,00 € (gjashtëqind euro)**, të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj brenda 1 (një) muaji, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumë prej 40 € (katërdhjet) euro në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

**I KONFISKOHEN** të pandehurit masa drusore 7 trungje të llojit “Breu”, me gjatësi 17-20m, më vëllim të përgjithshëm prej 5.38m<sup>3</sup>

**Të pandehurit J..I. i kthehen** Kamionin M.. me targa ..., me numër të shasisë W..., çelësat, dhe leja e qarkullimit të sekuestruar përkohësisht nga i pandehuri, menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

E dëmtuara D.. për A.. e P.. K.. B... e N... në P.., realizimin e kërkesës juridike udhëzohet në kontest civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme me datën 08.09.2023 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1212/23, ndaj të pandehurit J..I., për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 349 par. 3 lidhur me par 2 dhe par 1 të KPRK-së, me propozim që konform nenit 235 par. 1 nën par 1.9, 270 të KPPRK-së, të bëhet konfiskimi i përhershëm sendeve dhe atë masa drusore dru teknik, prej 5.38 m<sup>3</sup> të llojit breu pa damkë pyjore për transport si dhe kamionin M.. me targa ....., me numër të shasisë W.., çelësat, dhe leja e qarkullimit. Përgjegjëse do të jetë A..

për A.. e P.. së S.. dhe K.. në pajtim me Ligjin për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo Konfiskuar.

Ne shqyrtimin fillestar të datës 13.022024 gjykata në pajtim me nenin 241 par. 1 të KPPRK-se e ka udhëzuar te pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaroi për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Pasi i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta e leximit të aktakuzës gjykata është bindur se i pandehuri i ka kuptuar aktakuzat dhe nuk kanë nevojë për sqarime shtesë. Me pas gjykata e ka njoftuar te pandehurin për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë. I pandehuri është deklaruar se e pranoi fajësinë për veprën penale sipas aktakuzës, jam penduar dhe shton se është e vërtetë që e kam kryer këtë veprë dhe premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të këtilla.

Në vlerësimin e pranimit të fajësisë nga ana e te pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit të Shtetit e cila ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, pasi pranimin e fajësisë e kanë bërë në mënyrë vullnetare e po ashtu gjen mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Ndërsa mbrojtësi i te pandehurit av. Menduh Mulhaxha ka deklaruar se: meqenëse i pandehuri veç e pranon veprën penale sipas aktakuzës, kërkojmë nga ana gjykatës që me rastin e vendosjes mbi dënim të ketë parasysh pranimin e fajësisë, gjendjen e tij të dobët ekonomikë, i pa punë, pa të ardhura personale, jeton me qera, dhe se kjo është hera e parë që ballafaqohet me ligjin, se masa drunore është marrë me pronën e familjes së tij dhe atë me qëllim të pastrimit të pronës së tij nga trupat e thatë të dëmtuar nga era e bora, sinqeriteti i tij se nuk ishte në dijeni se ajo zonë është në kuadër të parkut kombëtar, ndihet i penduar për veprën e tij dhe premtonte se në të ardhmen nuk do ta përsërisë një veprim të tillë, ashtu që ndaj të njëjtit të shqiptohet një dënim sa më i butë, njeherit kërkojmë nga gjykata që nijeti i sekuestruar kërkojmë që te pandehurit të kthehet kamioni i tipit M.. me tabelle ..., leja e qarkullimit dhe çështja e kamionit meqenëse ky është i vetmi mjet me të cilin siguron ekzistencën e familjes së tij..

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 244 i KPPRK-së, si dhe janë vërtetuar faktet nga neni 242 par. 6 të KPPRK-se, ndërsa aktakuza mbështet në këto prova siç janë: fletëparaqitja e rojtarit të natyrës së parkut kombëtar, raport për fletëparaqitje/ përshkrimi i aktiviteteve të rojës- kujdestarit në terren; procesverbal i dt.23.06.2023; fotografitë e drurëve të prerë dhe të vendit të ngjarjes; raporti i oficerit policor Gj.. Q.. i dt. 21.06.2023, deklaratat e të dyshuarit J.l., të dhëna në polici më datë 21.06.2023 dhe në prokurori 28.07.2023, Vërtetimi mbi Sekuestrimin e Sendeve i dt. 21.06.2023, Kërkesa për Konfiskimin e Përkohshëm të Sendeve dt. 29.06.2023, Urdhër të Përkohshëm i Ndalimit dt. 23.06.2023, si dhe të shikohen shkresat tjera në lëndë, andaj ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehurit.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili mbështet në provat në baze të së cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 349 par.3 lidhur me par 2 dhe par 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata mori pranimin e fajësisë, keqë ardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, ne bazë të dhënave nga sistemi smil rezultoi se i njëjti është i pa dënuar, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si ne dispozitat të këtij aktgjykimi mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet në shumë prej 20,00 € për paushallit gjyqësor dhe për taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimit 20,00 €.

Vendimi që të pandehurit ti konfiskohen masa drusore 7 trungje të llojit “Breu”, me gjatësi 17-20m, më vëllim të përgjithshëm prej 5.38m<sup>3</sup> gjykata e morri duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 235 par. 1 nën par 1.9 të KPRK-së dhe nenit 271 dhe 277 të KPPRK-së, pasi që këto sende janë dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale.

Gjykata duke vlerësuar propozimin e Prokurorit të Shtetit për konfiskim të kamionin MAN, me ngjyrë të portokalltë me targa ..., me nr. të shasis W..., ka gjetur se nuk ka bazë ligjore për konfiskim të përhershëm të këtij kamioni, bazuar në provat mbi të cilat është mbështetur ky propozim nuk është vërtetuar se kamioni për të cilën është kërkuar konfiskimi, ka mundur kryerjen e veprës penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor apo nuk është përfituar me kryerjen e veprës penale, ngase gjykata të pandehurin e ka gjetur fajtor për veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par. 3 lidhur me par 2 dhe par 1 të KPRK-së e cila vepër për të cilën është akuzuar i pandehuri kryhet në momentin e prerjes së drunjtëve me qëllim të vjedhjes, ndërsa rrethanë kualifikuese është fakti nëse vepra penale është kryer në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtura apo në pyllin tjetër me destinim të posaçëm.

Andaj gjykata nga të cekurat më lartë por edhe sipas detyrës zyrtare ka gjetur se një propozim i tillë nuk ka mbështetje në dispozitën ligjore të neni 113 të KPPRK-së.

Komfor neni 462 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil meqenëse gjatë shqyrtimit fillestar nuk janë administruar prova me të cilat do të vërtetohet lartësia e dëmtit e shkaktuar nga veprimet e të pandehurit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë konform neni 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor neni 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL  
2023:156438, 01.03.2024**

**Bashkëpunëtorja profesionale**

Edona Berisha Kastrati

**G j y q t a r i**

Musë POVATAJ

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate